


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. 36/18 Prot.

Tiranë, më 15/06/2020

URDHËR

Nr. 180, datë 15.06.2020

**“PËR
NJOFTIMET E AKTEVE JASHTËGJYQËSORE NGA NOTERI”**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7 pika 2 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar dhe të nenit 134, pika 4, të ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”,

URDHËROJ:

1. ~~Komunikimi i një kujtese, deklaratë a një dokument nga noteri, një personi tjetër me telegrame, fakse e telefakse kryhet sipas rregullave të përcaktuara në këtë urdhër.~~
2. Komunikimi i një kujtese, deklaratë a një dokumenti nga noteri me telegram, faks ose telefaks kryhet vetëm në rastet kur kërkohet për t’u njoftuar nga personi posaçërisht nëpërmjet këtyre mjeteve ose kur e kërkojnë rrethana të veçanta ose nevoja e një njoftimi të shpejtë.
3. Në rastet kur komunikimi kryhet nëpërmjet këtyre mjeteve, noteri mban për këtë qëllim një procesverbal të posaçëm, ku tregohen:
 - a) të dhënat e kontaktit të personit që merr komunikimin;
 - b) të dhënat e kontaktit të personit i cili kërkon të kryhet njoftimi;
 - c) të dhënat e adresës prej ku nisët njoftimi;
 - ç) të dhënat e adresës që i drejtohet njoftimi;
 - d) mjeti i përdorur për njoftim;
 - dh) data dhe ora e saktë e komunikimit;
 - e) personi me të cilin komunikon dhe qëllimi i njoftimit;
 - ë) kopje e fletës së regjistrimit nga pajisja përkatëse elektronike për dërgimin e mesazheve që provon dërgimin e njoftimit në të dhënat e telegramit, faksit ose telefaksit të marrësit.



4. Në çdo rast, komunikimi i kryer me telegrame, fakse e telefakse konsiderohet i marrë vetëm në rastet kur personi ndaj të cilit i drejtohet njoftimi vërteton me shkrim, me shkresë dorazi e me mënyra të tjera që garantojnë një njoftim të rregullt, marrjen e njoftimit.
5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen noterët.
6. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për marrjen e masave për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI

ETILDA GJONAJ (SALIU)


REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E DREJTËSISË